



8 dhjetor 2021

KOMUNIKATË

Në Konferencën për Integrimin e Tregut të Energjisë Elektrike nënshkruhet marrëveshja për njohjen reciproke të licencave

Kosova dhe Shqipëria që nga dje janë një hap më afër tregut të përbashkët të energjisë elektrike.

Konferenca dy-ditore për Integrimin e Tregut të Energjisë Elektrike, që ka nisur dje, synon të trajtojë reformat kryesore të sektorit të energjisë elektrike që të dy vendet duhet të zbatojnë. Një moment shumë i rëndësishëm, për sektorin është shënuar me nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Rregullatorëve të energjisë të Kosovës dhe të Shqipërisë (ZRRE dhe ERE) për njohjen reciproke të licencave të tregtisë dhe furnizimit me energji elektrike. Zhvillimi i një tregu të integruar rajonal të energjisë elektrike do të nxisë konkurrencën dhe do të përmirësojë sigurinë e furnizimit me çmime më të përballueshme.

Përfaqësues të sektorit të energjisë nga Kosova dhe Shqipëria kanë diskutuar rreth çështjeve kyçe në sektor, me theks në politikat dhe bazën rregullative për krijimin e një tregu të përbashkët.

Konferenca është organizuar nga ZRRE nën, mbështetjen e projekteve të financuara nga USAID, Aktiviteti për Zhvillimin e Tregjeve Rajonale të Energjisë në Evropë dhe Euroazi i USAID-it (DREM) dhe Aktiviteti për Energji të Qëndrueshme në Kosovë (ESA).

Konferenca do të vazhdojë edhe sot ku do të mbahen trajnime që do të fokusohen në mënyrën e funksionimit të Bursës Shqiptar të Energjisë, ALPEX.